

RAPORT MONITORIMI
mbi aktivitetin e KMSHC-së si dhe performancën e
produkteve/shpenzimeve për periudhën
Janar-Dhjetor 2025

Në mbështetje të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”, Udhëzimit plotësues nr. 2, datë 24.01.2025, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”, Udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka kryer monitorimin e buxhetit për periudhën Janar-Dhjetor 2025 nëpërmjet vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore dhe krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuara. Monitorimi është procesi që lidh realizimin e objektivave dhe produkteve me fondet përkatëse të planifikuara për arritjen e tyre.

Misioni dhe vizioni ynë ka qenë dhe vijon të mbetet garantimi i zbatimit të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunsin civil”, i ndryshuar dhe krijimi i një administrate të qëndrueshme, profesionale, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike, duke u kujdesur që institucionet e administratës publike, gjatë administrimit të shërbimit civil, të udhëhiqen nga parimet e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, transparencës dhe profesionalizmit.

Për këtë arsye, realizimi i mbikëqyrjes/inspektimit dhe zbatimi i ligjit për administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civil, si dhe evidentimi i shkeljeve, në bazë të të cilave Komisioneri ushtron vendimmarrjen e tij në përputhje me Nenin 15 të ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kanë qenë në fokus të punës së KMSHC për realizimin e qëllimit të programit, duke menaxhuar me korrektësi dhe efijence fondet e alokuara nga buxheti i shtetit.

Komisioneri ka të miratuar dhe operon me një produkt të vetëm në Programin 0110, në “shpenzimet korrente”, **Mbikëqyrje të kryera sipas planit vjetor si dhe inspektime të realizuara sipas problematikave të ndryshme**, ku parashikimi është **nr. 215 njësi**.

Në lidhje me procesin e hetimit administrativ, gjatë periudhës së raportimit, Komisioneri ka trajtuar **139** informacione (**7 nga të cilat i përkasin periudhës përpara raportimit**), prej të cilave procesi ka përfunduar në **134** raste, ndërsa **5** raste të tjera, janë mbartur për vitin pasardhës.

Gjatë periudhës objekt raportimi, me urdhër të Komisionierit, është kryer procesi i inspektimit të thelluar në lidhje me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil në **9** institucione të vetëqeverisjes vendore (Bashkitë Divjakë, Delvinë, Kukës, Lushnjë, Patos, Vlorë, Cërrik, Prrenjas dhe Prefekti i Qarkut Shkodër).

Gjatë periudhës së raportimit, Komisioneri ka kryer procesin e mbikëqyrjes së përgjithshme në 17 institucione pjesë e shërbimit civil (8 nga të cilat të mbartura nga viti 2024).

Njëkohësisht gjatë periudhës së raportimit, Komisioneri ka kryer edhe 9 procese mbikëqyrjeje orientuese, të cilat do të trajtohen në vijim të këtij informacioni:

Gjatë kësaj periudhe Komisioneri ka ndjekur procesin e mbikëqyrjes në vazhdim (procesi i verifikimit të zbatimit të vendimeve paralajmëruese) për 39 vendime paralajmëruese (nga të cilat 13 të mbartura nga një vit më parë). Rezulton se procesi është përmbyllur me vendim përfundimtar në 26 raste dhe 13 të tjera janë në proces për shkak të kompleksitetit të procedurave që duhet të kryhen.

Në raport me vendimet e dala gjatë periudhës së raportimit, rezulton se ka përfunduar me vendim 47 procese mbikëqyrje/inspektimi apo hetimi administrativ, nga të cilat: 19 vendime të dala në përfundim të procesit të inspektimit apo hetimit administrativ, ku nuk janë konstatuar shkelje e, për këtë arsye, nuk janë lënë detyra, dhe 28 procese janë përmbyllur me vendime paralajmëruese për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë (nga të cilat, për 6 raste afati përfundon në vitin 2026).

Në zbatim të detyrës së ngarkuar në pikën 7, të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë nr.1233 prot., datë 11.11.2025, është kërkuar informacion nga Ministritë e linjës dhe Departamenti i Administratës Publike lidhur me kostot financiare për buxhetin e shtetit si pasojë e vendimet gjyqësore të paekzekutuara deri në dhjetor 2025.

Një nga veprimtaritë e Komisionerit përgjatë periudhës së raportimit, ka qenë pjesëmarrja në seancat e zhvilluara nga gjykatat administrative për 19 procese gjyqësore, ku Komisioneri është thirrur si palë e paditur apo palë e tretë nga nëpunësit civilë apo nga institucionet e administratës publike.

Pranë Gjykatave më të larta janë për gjykim 74 procese administrative për të cilat realizohet kontroll i vazhdueshëm. Ashtu siç e kemi theksuar edhe më parë, rekomandimet e Komisionerit, apo parashtrimet e bëra prej tij përpara gjykatës kanë vijuar të vlerësohen të drejta dhe janë marrë në konsideratë nga këto të fundit, në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative.

Gjatë periudhës së raportimit janë trajtuar 8 kërkesa të ardhura nga institucione publike për dhënie mendimi të specializuar dhe asistencë teknike lidhur me problematika të dala gjatë procesit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Gjithashtu, janë trajtuar 4 kërkesa nga nëpunës civilë dhe përmbarues gjyqësorë për ndërhyrjen e Komisionerit në rastet e moszbatimit të këtyre vendimeve.

Në kuadër të respektimit të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, janë trajtuar 12 kërkesa për informacion të ardhura në adresë të Koordinatorit për të drejtën e informimit. Gjithashtu është administruar dhe përditësuar regjistri i kërkesave.

Gjatë vitit 2025 është ofruar asistencë teknike në **27 institucione** të vetëqeverisjes vendore, lidhur me procedurat që duhet të ndiqen gjatë ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe në proceset disiplinore. Kjo veprimtari është dokumentuar përmes akteve të konstatimit dhe ka kontribuar në rritjen e korrektësisë ligjore dhe parandalimin e shkeljeve procedurale.

Është trajtuar dhe kthyer përgjigje **1** kërkesë të ardhur nga një institucion i administratës publike përmes të cilës është kërkuar interpretim/sqarim, lidhur me zbatimin në praktikë të disa dispozitave ligjore e nënligjore të legjislacionit për shërbimin civil.

Struktura organizative dhe organizimi i brendshëm

Veprimtaria e institucionit ushtrohet në përputhje me strukturën dhe organikën bazuar në Vendim Nr. 37/2024, “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 98/2014 ”Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”, ndryshuar me Vendimin nr. 91/2022, të Kuvendit të Shqipërisë “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 98/2014 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”.

Organika e Komisionerit përbëhet prej **37** punonjësish. Në periudhën objekt raportimi është realizuar 1 procedurë rekrutimi. Aktualisht Komisioneri në përbërjen e tij ka **36** punonjës. Përsa i përket trajnimeve të realizuara, në bashkëpunim me Shkollën e Administratës Publike (ASPA) janë trajnuar 11 (njëmbëdhjetë) punonjës, 6 (gjashtë) nga të cilët trajnuar për temën mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Nëpërmjet strukturës përgjegjëse janë mbikëqyrur dhe administruar burimet njerëzore në zbatim të parimeve dhe kritereve të legjislacionit në këtë fushë, si dhe janë kryer proceset e vlerësimit të rezultateve në punë të punonjësve, në përputhje me afatet ligjore.

Realizimi i Treguesve ekonomiko-financiarë

Me ligjin nr. 115/2024 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2025”, fondet e akorduara për funksionimin normal institucional në total u miratuan në vlerën **98.631.000 Lekë**, përfshirë edhe fondin e veçantë.

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor i alokuar për vitin 2025, të ndryshuara gjatë periudhës objekt raportimi me aktin normativ nr. 11, datë 19.12.2025, u shpenzuan **92,932,800 (lekë)**, ose **96,05. %**, e buxhetit të planifikuar për vitin 2025. Në mënyrë të detajuar kjo situatë paraqitet në tabelën e mëposhtme:





Tabela Realizimi i shpenzimeve përkundrejt totalit të buxhetit të akorduar për vitin 2025

Llog. Ekonomike	Përshkrimi	Plani fillestar viti 2025 (në lekë)	Plani i rishikuar viti 2025 (në lekë)	Realizimi Janar-Dhjetor 2025 (në lekë)
600	Fond Page	66,060,000	62,560,000	62,043,686
601	Kontributi për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	13,531,000	10,531,000	9,850,626
602	Mallra dhe shërbime të tjera	16,350,000	16,350,000	16,067,687
605	Transferta korente jashtë vendit	200,000	200,000	83,076
606	Transferta për Buxhetet Familjare dhe Individët	490,000	1,291,800	1,214,470
230-231	Shpenzime kapitale Blerje pajisje zyre dhe elektronike	2,000,000	2,000,000	0
T O T A L I		98,631,000	92,932,800	89,259,545
<i>Në % kundrejt totalit</i>				96.05 %

Aktivite në funksion të realizimit të qëllimit të politikës së programit

Në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike dhe kemi marrë pjesë në mbledhjen e komisionit të Posaçëm të zhvilluar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave për rikthimin në detyrë të nëpunësve civile si dhe po administrojmë aktet e emërimit të nëpunësve të rikthyer në detyrë.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional në përgjigje të kërkesës së tyre kemi informuar Avokaturën e Shtetit lidhur me nivelin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës publike.

Gjatë periudhës objekt raportimi janë trajtuar dhe kthyer përgjigje 21 kërkesave të ardhura nga institucionet publike përmes të cilave është kërkuar sqarim, lidhur me zbatimin në praktikë të nenit 65, germa "c", të ligjit nr. 152/2013, dispozitë e cila urdhëron lirimin nga shërbimi civil të nëpunësve që kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë.

Përgjatë periudhës së raportimit, një pjesë e rëndësishme e këtij bashkëpunimi ka qenë përmbushja e detyrimeve në kuadër të zbatimit të parimit të llogaridhënies, para Kuvendit të Shqipërisë. Konkretisht, Komisioneri ka dhënë një kontribut të rëndësishëm nëpërmjet raportimeve dhe informacioneve të ndryshme dërguar Kuvendit të Shqipërisë:

Një pasqyrë e përmbledhur e veprimtarive të realizuara gjatë periudhës së raportimit jepet në vijim:

- :: Raportim periodik vjetor në kuadër të mekanizmit të ngritur pranë Kuvendit të Shqipërisë për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura, dërguar Drejtorisë së Shërbimeve të Monitorimit.
- :: Raportim periodik vjetor në lidhje me veprimtarinë e përgjithshme të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në zbatim të ligjit, dërguar Drejtorisë së Shërbimeve të Monitorimit.
- :: Raportim periodik vjetor në lidhje me zbatimin e detyrave të Kuvendit të lëna për Komisionerin në rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë për vitin 2024.
- :: Në zbatim të parimit të llogaridhënies dhe në vijim të mbështetjes së vazhdueshme dhe vlerësimit nga ana e Kuvendit të Shqipërisë për nismën e Komisionerit që synon të ndikojë pozitivisht në sjelljen e administratës publike gjatë proceseve zgjedhore, në përputhje me standardet evropiane dhe në funksion të forcimit të shtetit ligjor, Komisioneri ka informuar Kuvendin, me shkresën nr. 429 prot., datë 03.04.2025, lidhur me masat e ndërmarra për të garantuar zbatimin e ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, në koherencë edhe me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe akteve rregullatore të nxjerra nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si dhe Vendimit Nr. 122, datë 26.02.2025, të Këshillit të Ministrave.

Në kuadër të bashkëpunimit për realizimin e procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit për nëpunësin civil gjatë zgjedhjeve të përgjithshme për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, Komisioneri ka përcjellë në adresë të Departamentit të Administratës Publike shkresën Nr. 118 Prot., datë 05.02.2025, me anë të së cilës është dërguar për njohje dhe zbatim Udhëzuesi i Komisionerit Nr. 15, datë 15.01.2025, si dhe modelet e akteve që do të materializojnë procesin.

Në kuadër të bashkëpunimit për realizimin e procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit për nëpunësin civil gjatë zgjedhjeve të përgjithshme për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, Komisioneri ka përcjellë në adresë të Departamentit të Administratës Publike shkresën Nr. 118 Prot., datë 05.02.2025, me anë të së cilës është dërguar për njohje dhe zbatim Udhëzuesi i Komisionerit Nr. 15, datë 15.01.2025, si dhe modelet e akteve që do të materializojnë procesin.

Në funksion të këtij procesi, Komisioneri ka kërkuar nga DAP që të marrë masat për të caktuar koordinatorin/koordinatorët, me të cilët do të komunikohet gjatë periudhës zgjedhore. Në përmbushje të kësaj kërkesë, DAP ka caktuar një koordinatör të përgjithshëm, si dhe koordinatörë të posaçëm për çdo institucion qendror të administratës

shtetërore (*Kryeministria dhe ministrinë e linjës*), të cilët kanë ndërvepruar ngushtësisht me inspektorët e Komisionerit të caktuar me Urdhrin e Brendshëm Nr. 9, datë 14.01.2025, për ndjekjen e ecurisë së procesit në këto subjekte, si në drejtim të verifikimit të të dhënave, ashtu edhe sa i takon problematikave të ndryshme të dala gjatë këtij procesi.

Në funksion të sigurimit të sjelljes korrekte dhe të paanshme të nëpunësve që kryejnë detyrat në sistemin e shërbimit civil, në këtë situatë specifike zgjedhore, ky bashkëpunim ka vijuar edhe me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Bashkëpunimi me institucionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka nisur me shkresën nr. 428 prot., datë 03.04.2025, drejtuar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, përmes së cilës është paraqitur një informacion në lidhje me masat e marra nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të zhvillimit normal të procesit zgjedhor, në përputhje edhe me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, përgjatë fushatës zgjedhore.

Me qëllim mbështetjen e këtij institucioni, për zbatimin e drejtë dhe të unifikuar në praktikë të ligjit, në përmbajtjen e udhëzimeve të Komisionerit për procesin zgjedhor, janë orientuar institucionet për të evituar pengesat në pjesëmarrjen e kategorisë së nëpunësit civil në administratën zgjedhore të emëruar nga KQZ, në përbërje të komisioneve përkatëse.

Po kështu, Komisioneri ka kërkuar nga institucionet, që, në bashkëpunim me KQZ-në, **të standardizojnë autorizimet** që lejojnë nëpunësit civilë, apo edhe të gjithë nëpunësit e tjerë të administratës publike, për të marrë pjesë në administratën zgjedhore, duke parashikuar shprehimisht në to, detyrimet, përgjegjësitë administrative, civile dhe penale, sipas rastit, si edhe të drejtat që ata kanë, me qëllim që nëpunësi t'i njohë dhe t'i respektojë ato, duke ndikuar në këtë mënyrë që procesi zgjedhor të njohë rritje të integritetit dhe besueshmërisë së tij.

Njëkohësisht, është kërkuar që institucionet, detyrimisht, të dërgojnë pranë KQZ-së dhe pranë Komisionerit këtë autorizim, menjëherë pasi ai të marrë fuqi ligjore, duke mos e lënë këtë proces të zhvillohet vetëm në vullnetin e punonjësit, të cilit i është miratuar kërkesa në këtë rast, për të dorëzuar këtë akt pranë institucioneve përkatëse.

Për të gjitha këto aspekte, është informuar edhe institucioni i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si në aspektin e një prej institucioneve të pavarura që punëson nëpunës civilë, ashtu edhe në cilësinë e institucionit që administron procesin zgjedhor.

Me qëllim që në raportim të përfshihen gjithë të dhënat që kanë lidhje me procesin e monitorimit, Komisioneri ka vijuar bashkëpunimin me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, edhe pas përfundimit të procesit zgjedhor, duke i kërkuar këtij institucioni, informacion në lidhje me konstatimet e tyre apo denoncime të regjistruara pranë tij, për veprime të nëpunësve civilë të çdo niveli të administratës publike që vijnë në kundërshtim me rregullimet ligjore për administrimin e procesit zgjedhor, apo për administrimin e

shërbimit civil, duke evidentuar punonjësin dhe llojin e shkeljes, për rastet kur ata janë proceduar administrativisht, apo janë në proces hetimi administrativ.

Në përgjigje të shkresës nr. 533 prot., datë 23.05.2025, "Kërkesë për informacion në lidhje me konstatime të institucionit të KQZ-së apo denoncime të ardhura pranë këtij institucioni, për veprime të nëpunësve civilë, të çdo niveli të administratës publike, që vijnë në kundërshtim me rregulloret ligjore për administrimin e procesit zgjedhor dhe të shërbimit civil", të Komisionerit, me shkresën nr. 4877/1, datë 12.06.2025, KQZ ka informuar Komisionerin se ka shqyrtuar 11 denoncime që kanë pasur si objekt përfshirjen e nëpunësve civilë në veprimtari të ndaluara gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025. Në përfundim të shqyrtimit të këtyre rasteve, nga ana e KQZ nuk është konstatuar shkelje e provuar në kuptim të ndalimeve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Aktivitete të tjera mbështetëse

Është ofruar asistencë teknike në disa njësi të vetëqeverisjes vendore lidhur me procedurat që duhet të ndiqen prej tyre gjatë ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Kjo veprimtari është evidentuar në aktet e konstatimit të mbajtura gjatë vizitës në institucionet: Bashkia Cërrik, Bashkia Belsh, Bashkia Gramsh, Bashkia Vlorë, Bashkia Selenicë, Këshilli i Qarkut Vlorë, Bashkia Kukës, Bashkia Mirditë, Këshilli Qarkut Kukës, në kuadër të mbikëqyrjes së orientuar.

Në kuadër të zbatimit të angazhimeve të përcaktuara në marrëveshjen dypalëshe të bashkëpunimit të nënshkruar më datë 03.11.2022, është kontribuar në mbajtjen e kontakteve të vazhdueshme gjatë gjithë vitit 2025, si dhe në organizimin dhe zhvillimin e takimit të përbashkët me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili u zhvillua më datë 31.10.2025, në Tiranë.

Në kuadër të bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare, si dhe duke vlerësuar rolin e rëndësishëm të tyre, në përmbushjen e standardeve zgjedhore në vendin tonë, anëtarë të grupit të punës të Komisionerit, në datën 29 Prill 2025, organizuan një takim të përbashkët pune me vëzhgues të OSBE/ODIHR në ambientet e institucionit të Bashkisë Dropull, gjatë monitorimit në këtë subjekt.

Në raport me interesimin e shfaqur nga grupi i vëzhguesve, për veprimtarinë e Komisionerit, ata u informuan për rolin që kryen institucioni në monitorimin e sjelljes së nëpunësve civil gjatë fushatës elektorale; për udhëzimin përkatës që i është dërguar të gjitha institucioneve, pjesë e shërbimit civil, si dhe për metodologjinë përkatëse që do të ndiqet deri në përgatitjen e raportit përfundimtar të vlerësimit për situatën e konstatuar përgjatë periudhës zgjedhore. Lidhur me këtë proces, vëzhguesit u informuan gjithashtu, edhe mbi rolin që luajnë grupet e monitorimit të ngritura nga institucionet, si dhe me mënyrën e ndërveprimit të tyre me institucionin e KMSHC-së.

Në datën 10 janar 2025, në ambientet e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u zhvillua një takim ndërmjet përfaqësuesve të Komisionerit dhe Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), me kërkesën e tyre, gjatë të cilit u diskutuan çështje të rëndësishme lidhur me procesin zgjedhor të majit 2025, u analizua situata socio-politike aktuale dhe sfidat me të cilat përballet procesi zgjedhor, si: moscenimi i lirive dhe të drejtave politike të shtetasve; sigurimi i garancive për të ruajtur nga shpërdorimi burimet shtetërore; intimidimi dhe përdorimi i papërshtatshëm i punonjësve të administratës publike për qëllime elektorale, etj.

Nga të dy palët u vlerësua si i frytshëm bashkëpunimi i deritanishëm mes dy institucioneve, i cili ka qenë i tillë edhe në zgjedhjet e mëparshme, dhe njëkohësisht palët u angazhuan për ta vijuar më tej këtë bashkëpunim edhe përgjatë këtij procesi zgjedhor.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, përfaqësues nga institucioni i Komisionerit kanë marrë pjesë në tre Konferenca Vjetore Ndërkombëtare të organizuar nga: Instituti Ndërkombëtar i Shkencave Administrative (IIAS), Grupi Evropian për Administratën Publike (EGPA), dhe nga Shoqata Ndërkombëtare e Shkollave dhe Instituteve të Administratës (IASIA),

Sa më lart prezantuar, vlerësojmë dhe angazhohemi se respektimi i ligjit dhe zbatimi i tij janë dhe do të vazhdojnë të jenë parimet bazë të punës sonë në përdorimin e fondeve publike me efektivitet, ekonomi dhe eficensë.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Lefterije Lleshi Luzi



Për Grupin GSM:

Lefterije LLESHI LUZI

Kryetar _____

Arbana BASHA

Anëtar Arbana Bash

Enkelejda HEBIBASI

Anëtar Enkelejda Hebibasi

Luiseda ZHAPA

Anëtar Luiseda Zhapa

Altin SHUMELI

Anëtar _____

Irma VANI

Anëtar Irma Vani

Ollga HODAJ

Anëtar/ Sekretar Teknik Ollga Hodaj

ANEKSI nr.1 Raporti Përbledhës i Shpenzimeve të Ministrisë/Institucionit Buxhetor

Periudha e Raportimit 12-2025

Emri i Grupit	Kodi i grupit	Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit											
		Viti pararendës 2024						Periudha raportuese					
		Shpenzime Faktike	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Vjetor VRI 2025	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Vjetor i Rishikuar VRI 2025	Struktura e shpenzimeve në %	Kryeshimi i planit vjetor	Shpenzime Faktike të Periudhës Raportuese	Struktura e shpenzimeve në %	Ndryshimi Vjetor (Plan - Fakt)	% e realizimit	
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)	(11)	(12)		
EMËRTIME													
Shpenzimet sipas programeve buxhetore													
Kodi i Programit		Emërtimi											
0110		Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi											
		687,298,557.32	1.00	98,381,000.00	0	98,381,000.00	0	-5,448,200.00	89,259,545.72	0	3,673,254.28	98.0%	
		88,738,657.22	1.00	88,381,000.00	0	88,381,000.00	0	-5,448,200.00	89,259,545.72	0	3,673,254.28	98.0%	
		0.00							0.00				
		88,738,657.22							88,259,545.72				
		Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik											
Emërtimi													
Artikulli													
600		63,281,024.00	70.62	66,050,000.00	67.15	62,560,000.00	67.32	-3,500,000.00	62,043,866.00	69.51	9,163,140.00	99.2%	
601		10,096,283.00	11.25	13,531,000.00	13.75	10,531,000.00	11.33	-3,000,000.00	9,950,636.00	11.04	680,374.00	55.5%	
602		15,556,881.22	17.34	16,350,000.00	16.62	16,350,000.00	17.59	0.00	16,067,637.72	18.00	292,312.28	98.3%	
603		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.0%	
604		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.0%	
605		66,159.00	0.10	200,000.00	0.20	200,000.00	0.22	0.00	63,075.00	0.09	116,924.00	41.5%	
606		718,200.00	0.80	240,000.00	0.24	1,291,800.00	1.39	1,051,800.00	1,214,470.00	1.36	77,330.00	94.0%	
		88,738,657.22	0.00	98,381,000.00	97.97	90,832,800.00	97.45	-5,448,200.00	89,259,545.72	100.00	1,673,254.28	98.2%	
230		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.0%	
231		0.00	0.00	2,000,000.00	2.03	2,000,000.00	2.15	0.00	0.00	0.00	0.00	0.0%	
		0.00	0.00	2,000,000.00	2.03	2,000,000.00	2.15	0.00	0.00	0.00	0.00	0.0%	
230		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.0%	
231		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.0%	
		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.0%	
		0.00	0.00	2,000,000.00	2.03	2,000,000.00	2.15	0.00	0.00	0.00	0.00	0.0%	
		88,738,657.22	100.00	98,381,000.00	0.00	92,832,800.00	100.00	-5,448,200.00	89,259,545.72	100.00	3,673,254.28	98.0%	
		0.00							0.00				
		88,738,657.22							89,259,545.72				
		0		0		0			0				

[Signature]

Emri	Letërsia Ueshi Luz
Firma	
Data	

Komisioneri

[Handwritten signatures and notes in blue ink]

ANEKSI 1.1 Raporti i Shpenzimeve të Ministrisë/Institucionit sipas kapitujve

Periudha e Raportimit 12-2025

Kodi i Ministrisë	Kodi i Kapitullit	Emërtimi i Kapitullit	Periudha raportuese /Vjetore	Buxheti	2025					Total	
					231	600	601	602	605		606
					Shtezime Kapitale të Trupëzues	Pagat	Kontribute Sigurimeve Shoqërore	Multa dhe Shërbime	Transfer. Korrente të Huaja	Transferta për Buxhetet Familjare dhe Individuel	Total
67	01	Nga Buxheti	2025	Plani fillestar	2,000,000	66,060,000	13,531,000	16,350,000	200,000	240,000	98,381,000
67	01	Nga Buxheti	2025	Plani i rishikuar	2,000,000	62,560,000	10,531,000	16,350,000	200,000	1,291,800	92,932,800
67	01	Nga Buxheti	2025	Fakti	0	62,043,686	9,850,626	16,067,688	83,076	1,214,470	89,259,545.72
67	01	Nga Buxheti	2025	Angazhime	0	0	0	0	0	0	0
67		Total	2025	Plani fillestar	2,000,000	66,060,000	13,531,000	16,350,000	200,000	240,000	98,381,000
67		Total	2025	Plani i rishikuar	2,000,000	62,560,000	10,531,000	16,350,000	200,000	1,291,800	92,932,800
67		Total	2025	Fakti	0	62,043,686	9,850,626	16,067,688	83,076	1,214,470	89,259,545.72
67		Total	2025	Angazhime	0	0	0	0	0	0	0
67		Ndryshimi ne vliere absolute	2025		2,000,000	516,314	680,374	282,312	116,924	77,330	3,673,354
67		Realizimi ne %	2025		0	99	94	98	42	94	96

Drejtuessi i Ekipit Menaxhues i8 Programit	Emri	Arbana Baasha	Komisioneri	Emri	Letërije Lleshi Luzi
	Firma			Firma	
	Data			Data	







Aneksi 1.2 "Shpenzimet Buxhetore në Total Programi dhe Total Ministrie/Institucioni Buxhetor"

Periudha e Raportimit 12-2025

Kodi i Ministris	Kodi i Programi	Emërtimi i Programit	Viti	Tipi i Buxhetit	Art. 231	Art. 600	Art. 601	Art. 602	Art. 605	Art. 606	Total
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2025	Plani fillestar	2,000,000	66,060,000	13,531,000	16,350,000	200,000	240,000	98,381,000
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2025	Plani i rishikuar	2,000,000	62,560,000	10,531,000	16,350,000	200,000	1,291,800	92,932,800
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2025	Shpenzime faktike	0	62,043,686	9,850,626	16,067,688	83,076	1,214,470	89,259,546
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2025	Angazhime	0	0	0	0	0	0	0
67		Ndryshimi ne vlere absolute	2025		2,000,000	516,314	680,374	282,312	116,924	77,330	3,673,254
67		Realizimi ne %	2025		0	99.2	93.5	98.3	41.5	94.0	96.0
67		Total i Ministrisë/Institucionit	2025	Plani fillestar	2,000,000	66,060,000	13,531,000	16,350,000	200,000	240,000	98,381,000
67		Total i Ministrisë/Institucionit	2025	Plani i rishikuar	2,000,000	62,560,000	10,531,000	16,350,000	200,000	1,291,800	92,932,800
67		Total i Ministrisë/Institucionit	2025	Shpenzime faktike	0	62,043,686	9,850,626	16,067,688	83,076	1,214,470	89,259,546
67		Total i Ministrisë/Institucionit	2025	Angazhime	0	0	0	0	0	0	0
67		Numri i punonjësve në Total	2025	Plani fillestar							37
67		Numri i punonjësve në Total	2025	Plani i rishikuar							36
67		Numri i punonjësve në Total	2025	Numri faktik							34

Drejtues i Ekipit Menaxhues te Programit	Emri	Letërfeja Lleshi Luzi
	Firma	
	Data	
Komisioneri	Emri	
	Firma	
	Data	

Handwritten signatures and initials in blue ink, including a large signature on the right and initials 'JL' and 'Holl' on the left.

Emri i Grupit	Kodi i grupit									
	Kodi i programit									
	Shpenzimet e Programit									
Emri i Periudhës	Viti paraqitës 2024		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Struktura e shpenzimeve në %	
	Shpenzime	Faktike	Struktura e shpenzimeve në %	Piani i vijor i shpenzimeve Viti 2025	Struktura e shpenzimeve në %	Adryshimi i planit vijor	Shpenzime Ekzakte të Periudhës/Progresive	Struktura e shpenzimeve në %	Mbryshimi i vijor (Plan - Fakt)	% e realizimit
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7 (5-3))	(8)	(9)	(10 (6-4))	(11 (8/5))
Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik										
EMËRTIME										
Kodi i Programit	Emërtimi									
600	63,281,024.00	71	66,050,000	67	62,560,000	67	62,560,000	70	516,314	99.2
601	10,656,293.00	11	13,531,000	14	10,531,000	11	10,531,000	11	680,374	94
602	15,656,861.22	17	16,350,000	17	16,350,000	18	16,067,687.72	18	282,312	98.3
603	0.00	0	0	0	0	0	0	0	0	0
604	0.00	0	0	0	0	0	0	0	0	0
605	86,199.00	0	200,000	0.20	200,000	0.22	0	0	0	0
606	716,200.00	0.90	240,000	0.24	1,291,900	1.4	1,051,800	1.4	77,330	94
	89,738,557.22	100	96,381,000	98	90,932,800	97.6	-5,448,200	100	1,673,254	98
220	0.00	0	0	0	0	0	0	0	0	0
231	0.00	0	2,000,000	2.0	2,000,000	2	0	0	2,000,000	0
	0.00	0	2,000,000	2	2,000,000	2	0	0	2,000,000	0
230	0.00	0	0	0	0	0	0	0	0	0
231	0.00	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	0.00	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	0.00	0	2,000,000	2	2,000,000	2	0	0	2,000,000	0
	89,738,557.22	100	98,381,000	100	90,932,800	100	-5,448,200	100	8,227,443	98
	0.00	0	96,381,000	0.00	92,932,800	0.00	88,236,546.72	0.00	6,227,442.66	0
Shpenzimet sipas produkteve të programit buxhetor										
Emërtimi										
Artikulli	Emërtimi									
Kodi i produktit	89,738,557.22	100	96,381,000	98	90,932,800	96	-5,448,200	100	1,673,254	98
89701AA	89,738,557.22	100	96,381,000	98	90,932,800	96	-5,448,200	100	1,673,254	98
	0.00	0	2,000,000	2	2,000,000	2	0	0	2,000,000	0
	0.00	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	0.00	0	2,000,000	2	2,000,000	2	0	0	2,000,000	0
	0.00	0	2,000,000	2	2,000,000	2	0	0	2,000,000	0
	0.00	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	0.00	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	89,738,557.22	100	96,381,000	98	90,932,800	96	-5,448,200	100	1,673,254	98
	0.00	0	96,381,000	0.00	92,932,800	0.00	88,236,546.72	0.00	6,227,442.66	0

Drejtuesi i Ekspit Menaxhues i Programit	Emri	Letërsija Llesh Lushi
	Firma	
	Data	
Komisioneri	Emri	
	Firma	
	Data	

[Handwritten signatures and initials]

RAPORTI 2/1 Shpenzimet e programit sipas kapitujve

Periudha e Raportimit 12-2025

Kodi i Ministrisë së Programit	Kodi i Programit	Emërtimi i Programit	Kodi i Kapitullit	Emërtimi i Kapitullit	Periudha raportuese / Vjetore	Buxheti		231	600	601	602	605	606	Total
						Shpenzime Kapitale të Trupësuara	Pagat							
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	01	Nga Buxheti	2025	Planifikuar	66,060,000	2,000,000	13,531,000	16,350,000	200,000	240,000	98,381,000	
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	01	Nga Buxheti	2025	Planifikuar	62,560,000	2,000,000	10,531,000	16,350,000	200,000	1,291,800	97,932,800	
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	01	Nga Buxheti	2025	Fakti	62,043,686	0	9,850,626	16,067,688	83,076	1,214,470	89,259,546	
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	01	Nga Buxheti	2025	Angazhime	0	0	0	0	0	0	0	
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi		Total	2025	Planifikuar								
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi		Total	2025	Planifikuar								
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi		Total	2025	Fakti								
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi		Total	2025	Angazhime								
67	01110	Ndryshimi ne vlerë absolute		Total	2025		516,314	680,374	282,312	116,524	77,330	3,673,254		
67	01110	Realizimi ne %		Total	2025		99.17	94	98.3	41.5	94	96.0		

Emri	Arbana Basha	Komisioneri	Letërsi Lehti Luti
Firma			
Data	Shkurt 2025		



ANEKSI nr.3 Raporti i performancës së produkteve të programit

ne/leke

Emri i Grupit	Kodi i grupit														
	Kodi i programit														
	01110														
Kodi i Produktit	Emërtimi i Produktit	Niveli maksim	Viti pararendur			Periudha Raportuese			Periudha Raportuese			Devijacioni i Kostove per Njesi			
			Sasia Faktike (Viti pararendur)	Shpenzimet Faktike (sipas viti pararendur)	Kosto per Njesi (sipas viti pararendur)	Sasia e sapa planit Filletar Vjetor	Shpenzimet e sapa planit Filletar Vjetor	Kosto per Njesi (sipa planit Filletar Vjetor)	Sasia Faktike (ne fund te vitit korent)	Shpenzimet Faktike (ne fund te vitit korent)	Kosto per Njesi Faktike (ne fund te vitit korent)	13=(12)-(3)	14=(12)-(6)	15=(12)-(9)	
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)	(11)	(12)	(13)	(14)	(15)	
Produktet e realizuara me shpenzimet buxhetore të programit															
96701AA	Mbledhje dhe inspektime të kryera	Numër misionesh mbledhjetjeje.	219	89,738,557	409,765	215	96,381,000	448,284	90,932,800	422,943	298	89,259,546	289,529	-110,236	-148,755
18AC201	Pajise elektronike dhe zyre te biera	Numër pajisje	0	0	0	0	2,000,000	0	2,000,000	0	0	0	0	0	0
T	Total			79,990,641			98,381,000		92,932,800			89,259,546			
Produktet e realizuara nga përdorimi i të ardhurave jashtë limitit (nga kapitulli 06)															

Drejuesi i Ekspit Menaxhues të Programit		Arbataj Susha		Komisioneri	
Emri	Firma	Emri	Firma	Emri	Firma
Data		Data		Data	

[Signature]

[Handwritten signatures and initials]

Aneksi 3.1 Raporti i performancës së produkteve të programit sipas artikuljeve

Periudha e Raportimit 12-2026

Kodi i Ministrisë	Kodi i Programit	Emërtimi i Programit	Kodi i Produktit	Emërtimi i Produktit	Tipi i Buxhetit	Sasia	Artikujt buxhetore						
							Total	231 Shpenzime Kapitale të Trepëzësara	600 Pagat	601 Kontitë e Sigurimeve e Shpëtojësore	602 Mallra dhe Shërbime	605 Transfer Korrente të Huaja	606 Transfera për Buxhetet Familjare dhe Individet
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	96701AA	Mbikëqyrje dhe inspektime të kryera.	Plani fillestar		96,381,000	0	66,060,000	13,531,000	16,350,000	200,000	240,000
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	96701AA	Mbikëqyrje dhe inspektime të kryera.	Plani i rishikuar		90,932,800	0	62,560,000	10,531,000	16,350,000	200,000	1,291,800
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	96701AA	Mbikëqyrje dhe inspektime të kryera.	Fakti		89,259,546	0	62,043,686	9,850,626	16,067,688	83,076	1,214,470
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	18AC201	Pajisje elektronike dhe zyre te biera	Plani fillestar		2,000,000	2,000,000	0	0	0	0	0
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	18AC201	Pajisje elektronike dhe zyre te biera	Plani i rishikuar		2,000,000	2,000,000	0	0	0	0	0
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	18AC201	Pajisje elektronike dhe zyre te biera	Fakti		0	0	0	0	0	0	0
				Totali shpenzime buxhetore	Plani fillestar		98,381,000	2,000,000	66,060,000	13,531,000	16,350,000	200,000	240,000
				Totali shpenzime buxhetore	Plani i rishikuar		92,932,800	2,000,000	62,560,000	10,531,000	16,350,000	200,000	1,291,800
				Totali shpenzime buxhetore	Fakti		89,259,546	0	62,043,686	9,850,626	16,067,688	83,076	1,214,470

Emri: _____
Firma: _____
Data: _____

Emri: _____
Firma: _____
Data: _____

Emri: _____
Firma: _____
Data: _____

Emri: _____
Firma: _____
Data: _____

(Handwritten signatures and initials)

Aneksi 3.2 Deviacioni kostos për njësi në vite

Line Ministry	Program Code	Program Meaning	KPI Target Periodicit	Output Code	Output Meaning	Type Title	2021	2022	2023	2024	2025
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi		96701AA	Mblikëqyrje dhe inspektime të kryera.	Target Qty	207	210	212	215	215
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi		96701AA	Mblikëqyrje dhe inspektime të kryera.	Planned Cost	57,800,000	61,153,000	63,960,000	95,481,000	96,381,000
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi		96701AA	Mblikëqyrje dhe inspektime të kryera.	Unit Cost (Planned)	279,227	291,200	311,132	444,088	448,284
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi		96701AA	Deviacioni i planit fillestar për njësi gjatë viteve	Revised Qty		11,973	19,932	137,966	4,186
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi		96701AA	Mblikëqyrje dhe inspektime të kryera.	Revised Cost		210	212	215	215
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi		96701AA	Mblikëqyrje dhe inspektime të kryera.	Unit Cost (Revised)	58,010,000	57,608,350	84,310,000	95,566,000	90,952,000
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi		96701AA	Mblikëqyrje dhe inspektime të kryera.	Actual Qty	210	211	212	219	298
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi		96701AA	Mblikëqyrje dhe inspektime të kryera.	Actual Cost	55,290,199	56,019,494	77,806,353	89,738,557	89,359,546
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi		96701AA	Mblikëqyrje dhe inspektime të kryera.	Unit Cost (Actual)	265,668	265,495	361,890	409,765	299,529
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi		18AC201	Deviacioni i kostos taktike për njësi gjatë viteve	Target Qty	10	10	10	10	10
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi		18AC201	Pajisje elektronike dhe zyre te blera	Planned Cost	2,000,000	1,000,000	3,000,000	2,000,000	2,000,000
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi		18AC201	Pajisje elektronike dhe zyre te blera	Unit Cost (Planned)	200,000	100,000	300,000	200,000	200,000
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi		18AC201	Deviacioni i planit fillestar për njësi gjatë viteve	Revised Qty	25	10	19	1	10
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi		18AC201	Pajisje elektronike dhe zyre te blera	Revised Cost	2,000,000	1,000,000	3,000,000	2,000,000	2,000,000
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi		18AC201	Pajisje elektronike dhe zyre te blera	Unit Cost (Revised)	80,000	100,000	157,895	2,000,000	200,000
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi		18AC201	Deviacioni i planit të rishikuar për njësi gjatë viteve	Actual Qty	25	20,000	57,895	1,842,105	1,800,000
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi		18AC201	Pajisje elektronike dhe zyre te blera	Actual Cost	1,606,656	998,400	2,184,288	0	0
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi		18AC201	Pajisje elektronike dhe zyre te blera	Unit Cost (Actual)	64,266	99,800	131,300	0	0
67	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi		18AC201	Deviacioni i kostos taktike për njësi gjatë viteve	Target Qty	21,509	35,574	21,509	0	0

[Handwritten signature]

Emri	Lofertje Lushaj Luzi
Firma	<i>[Handwritten signature]</i>
Data	Spisite 2026

[Handwritten signature]
[Handwritten signature]
[Handwritten signature]

Emri	Drejuesi Elqipt Menaxhues të Programit
Firma	<i>[Handwritten signature]</i>
Data	

Emri	Komisioneri
Firma	
Data	

Periudha e Raportimit 12-2025

ANEKSI nr.4 Raporti i realizimit të treguesve të performancës së programit

Emri i Grupit	Komisioneri për Mbrojtjen e Shërbimit Civil	Kodi i Grupit	67
Emri i Programit	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	Kodi i Programit	01110

Qëllimi i politikës së programit

Garantimi dhe respektimi i ligjit për shërbimin civil në institucionet qendrore, të pavarura dhe ato vendore.

Treguesit e performancës në nivel qëllimi

Kodi i treguesit	Emërtimi i treguesit	Njësia matëse	Fakti i Vitit Pararendës	Buheti Vjetor Plan fillëstar Vitit 2025	Buheti Vjetor Plan i Rishikuar Vitit 2025	Fakti i Periudhës/progressive	Ndërshkrimi (Plan - Fakt)	% e realizimit
	Numri i shkeljeve të konstatuara të ligjit të nepunësit civil							
Objektivi	Objektivat e politikës së programit							
	Rritja e nivelit të zbatimit të ligjit për shërbimin civil							
	Niveli i zbatimit të vendimeve të Komisionerit		100%	100%	100%	99%		
	Mbrojtje të realizuara në raport me numrin e mbikëqyrjeve të planifikuara.		95	95	95	78%		
	Procese inspektimi të filluara kryesisht në raport me nr. total të informacioneve të administruara nga Komisioneri.		20	22	22	88%		
	Periqindja e grave në poste drejtuese në raport me totalin e posteve drejtuese në shërbimin civil në KMSHC.		77	77	77	77		

Produktet

Kodi i treguesit	Emërtimi i treguesit	Numër misionesh mbikëqyrjeje.	215	215	215	288	0
9670JAA	Mbikëqyrje dhe inspektime të kryera.	leke	89,738,557	96,381,000	90,932,800	89,259,546	1,673,254
18AC203	Pajisje elektronike dhe zyre të biera	Numër pajisje	0	10	10	0	0
		leke	2,184,288	2,000,000	2,000,000	0	2,000,000

Emri	Arbana Busha	Emri	
Firma	<i>Arbana Busha</i>	Firma	
Data		Data	

[Signature]

[Signatures]